



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika b të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të dispozitave të nenit 6 të Ligjit nr. 02 / L - 57, për institucionet e kulturës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 11/07, prill 2007), dhe të dispozitave të nenit 34, pika 34.1, shkronja a të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më **31.10.2018**, merr këtë

V E N D I M

I.

Kuvendi i Komunës së Prishtinës është themeluar i Qendrës Kulturore të Prishtinës.

II.

Organizimi, funksionimi, përbërja e strukturës organizative, drejtimi, udhëheqja, financimi, planifikimi, transparenca dhe çështje të tjera të rëndësishme për Qendrën Kulturore të Prishtinës, do të rregullohen në bazë të Ligji për institucionet e kulturës, që është në fuqi, dhe Statutit të Qendrës Kulturore të Prishtinës.

III.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtorja e Kulturës.

IV.

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e publikimit të tij në tabelën e shpalljeve dhe në ueb- faqen e Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-030/01-0263806/18, më 01.11.2018

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta



Arsyetim

Kuvendi i Republikës së Kosovës e ka miratuar Ligjin për institucionet e kulturës. Ligji mban numrin 02 /L - 57, i cili është publikuar në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 11/07, prill 2007, dhe është në fuqi nga dt. 1 prill 2007.

Ligji rregullon themelimin, organizimin, funksionimin, përbërjen e strukturës organizative, drejtimin, udhëheqjen, financimin dhe planifikimin, transparencën dhe çështje të tjera të rëndësishme për institucionet e kulturës.

Në bazë të dispozitave të nenit 6 të ligjit të cekur, është paraparë që Kuvendi i Komunës të themelojë institucionin kulturor, respektivisht Qendrën Kulturore të Prishtinës.

Duke pasur parasysh këtë dispozitë dhe dispozitat të tjera të këtij ligji, themelues i Qendrës Kulturore të Prishtinës është Kuvendit i Komunës.

Kryetari i Komunës, në pajtim me kompetencat dhe përgjegjësitë që ka në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, i propozon Komitetit për Politikë dhe Financa që, në mbledhjen e saj, ta vë në rend të ditës për shqyrtim këtë propozimvendim dhe pas shqyrtimit, t'ia dërgojë Kuvendit të Komunës për miratim.

Ky propozim është bërë me qëllim të përmbushjes së dispozitës së nenit të cekur në hyrje të arsyetimit të këtij vendimi.